



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembl

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione

Mbledhja nr. 05

Prishtinë, më 07.03.2012, në orën 11.00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Suzan Novoberdali – kryetare, Rita Hajzeraj, Kurtan Kajtazi, Albana Gashi, Biserka Kostiq dhe Kymete Bajraktari.

Munguan: Justina Pula, Kimete Bytyçi dhe Duda Balje.

Pjesëmarrës të tjerë: Elita Vokshi-OSBE; Terina Dampier-OSBE; Bekim Kodraliu-OSBE; Elizabeta Gjikdoda-KDI; Visar Ramaj-INPO; Sakibe Jashari- Ambasada zvicerane; Viosar Bikliqi-praktikant; Nuredin Ibishi-CDF; Ukë Gashi-ZPRK dhe Burim Tahiri- praktikant.

Nga Stafi mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj - koordinator dhe Sulltane Gashi - zyrtare ligjore.

Mbledhjen e drejtoi, Suazan Novoberdali- kryetare. Ajo konstatoi se në bazë të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, janë plotësuar kushtet për mbajtjen e mbledhjes dhe propozoi këtë

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22 shkurt 2011;
3. Miratimi i amendamenteve të dhëna në Projektligjin për persona të verbër dhe persona pjesërisht të verbër;
4. Shqyrtimi i peticioneve;
5. Të ndryshme .

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22 shkurt 2012

Miratimi i procesverbalit u vendos që të bëhet në mbledhjen e radhës, për arsye se nuk është përkthyer me kohë në gjuhën serbe.

3. Miratimi i amendamenteve të dhëna në Projektligjin për persona të verbër dhe personat pjesërisht të verbër

Kryetarja- Njoftoi anëtarët e Komisionit se në këtë mbledhje nuk do të ketë miratim të amendamenteve, por do të njoftohemi me punën e grupit të punës.

Si grup i punës, kemi bashkëpunuar me Shoqatën për persona të verbër, sepse ata janë më së miri të njoftuar me problemet që i kanë.

Ajo njoftoi edhe me punën e grupit të punës për këtë Projektligj, i cili ka mbajtur dy ditë pune në Gjakovë me mbështetje të UNDP-së.

Atje kemi bërë disa propozimamendamente, mirëpo ndërkohë e kemi parë të nevojshme që për disa nene të këtij Projektligji të konsultohemi edhe me ministrat përgjegjës të ministrive përkatëse, me qëllim që në seancë plenare mos të paraqitet problem në miratimin e amendamenteve. Ajo tha se kemi pasur takim me ministrin për Punë dhe Mirëqenie Sociale, lidhur me nenin 7 të Projektligjit, meqë ka implikime buxhetore, ai mendon se nuk ka kosto të madhe, por duhet të konsultohemi edhe me ministrin e Financave. Vërejtja e tyre kryesore është, sepse ata nuk mund të përfitojnë në dy baza, pra edhe për efekt varfërie edhe për efekt verbërie dhe për arsye të këtij neni, ne sot nuk po i miratojmë këto amendamente, sepse ky nen është me një rëndësi të madhe. Gjithashtu, kemi biseduar edhe për Komisionin mediko-social dhe kemi kërkuar që në këtë komision të jenë tre mjekë okulistë dhe një përfaqësues nga Shoqata e personave të verbër, ndërsa për këtë çështje, nuk ka paraqitur problem ministria, edhe pse ne po presim sqarime rreth nenit 7 dhe duam të sigurohemi që i njëjti të kalojë në Kuvend dhe të zbatohet nga Qeveria.

Albana Gashi- Sa i përket nenit ku është ndryshuar dhe është bërë kompensimi i verbërisë dhe ku është 70% të pagës minimale, qëndrimi i Lëvizjes është që të jetë 70% të pagës mesatare, pasi që e kemi hequr kategorinë e tretë dhe numri i përfituesve është më i vogël, duke pasur parasysh që nuk mund të përfitojnë edhe për efekt verbërie edhe për efekt varfërie, duke e ditur sa është paga minimale, atëherë 70% e saj bën një pagë tejet minimale, kështu që ne konsiderojmë se duhet të merret për bazë paga mesatare.

Kryetarja- Duke u ndërlidhur me parafolësen, tha se sa i përket pagës minimale edhe shoqata është në pajtim me këtë. Ne, nëse shkojmë prej pagës minimale në pagë mesatare, me siguri do të hasim në problem, mirëpo sot vetëm po njoftohemi se çka është punuar dhe ju njoftova lidhur me këtë nen që ka mbetur të qartësohet më mirë.

Këto nuk janë definitive, do të kemi mundësi prapë të debatojmë për këtë Ligj dhe t'i shprehni edhe ju mendimet e juaja dhe të vendosim.

Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, lidhur me Projektligjin për personat e verbër, Komisioni mori qëndrim që të diskutohet serish dhe këto propozimamendamente të shqyrtohen dhe miratohen në një mbledhje të radhës së Komisionit.

4. Shqyrtimi i peticioneve

Rita Hajzeraj -Lidhur me shqyrtimin e peticioneve, njoftoi se kemi një kërkesë të adresuar nga një qytetar i Komunës së Lipjanit, por është shumë i paqartë dhe nuk i plotëson kriteret për shqyrtim, sepse nuk kuptohet domethënia e tij.

Kryetarja- Lidhur me kërkesën në fjalë, tha se si dokument është i paqartë dhe nuk kuptohet, nuk është në formën e duhur, por nëse i njëjti i plotëson kushtet formale dhe juridike, atëherë ne si Komision do ta shqyrtojmë, sepse edhe nëse i përket vetëm një personi ne duhet ta shqyrtojmë, por ky dokument është i paqartë.

Komisioni, lidhur me shqyrtimin e kësaj kërkesë nxori këtë,

Rekomandim

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, në mbledhjen e mbajtur më 07.03.2012, u njoftua me shkresën tuaj, por për shkak të të metave formale të saj, Komisioni iu rekomandon që t'i drejtoheni Zyrës rajonale për ndihmë juridike falas, konform nenit 27 të Ligjit nr. 04/L-017 për ndihmën juridike falas.

5. Të ndryshme

Kryetarja-Njoftoi me raportin e Institucionit të Avokatit të Popullit për ngjarjet e protestës së 14 dhe 21 janarit 2012. Këtë raport e ka kërkuar Komisioni për Punë të Brendshme i Kuvendit të Kosovës. Këtu janë nxjerrë edhe disa rekomandime. Këtë raport, ne do ta shqyrtojmë sa i përket aspektit të të drejtave të njeriut dhe a ka pasur shkelje në këtë protestë nga ana e policisë, nëse konsideroni se duhet ta thërrasim ministrin e Punëve të Brendshme, pra ne si Komision mund ta ftojme që të na japë disa sqarime.

Rita Hajzeraj- Tha se, është mirë që të vijë ministri në Komision, gjithashtu mund ta ftojme edhe një përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe të jemi të mirinformuar për atë ngjarje.

Albana Gashi- Duke u ndërlidhur me raportin, tha se duhet t'i ftojme personat përgjegjës edhe nga Inspektorati Policor i Kosovës, pra të informohemi drejtpërdrejt nga ta se çfarë kanë ndërmarrë ata në lidhje me policët, të cilët kanë përdorur dhunë të shfrenuar ndaj protestuesve.

Kryetarja- Ministria e Punëve të Brendshme ka bërë një raport për këto ngjarje, sepse e ka kërkuar Komisioni për Punë të Brendshme dhe është mirë që atë raport ta kemi edhe ne dhe të dalim me konkluzionet tona se ku ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut.

Rita Hajzeraj- Njoftoi Komisionin lidhur me monitorimin e Ligjit për Institucionin e Avokatit të Popullit dhe tha se është në përgatitje të një pyetësori ku do ta keni edhe ju si anëtarë të Komisionit. Ky monitorim do të shkojë sipas fazave që kanë kaluar edhe për ligjet e tjera, ndoshta do të ndryshojë diçka, sepse është ligj më specifik dhe ka të bëjë me punën e këtij institucioni, nuk mund të shkojmë me pyetësor të njëjtë, sepse dallon specifika e këtij Ligji. Për këtë Ligj kemi përkrahjen e OSBE-së, kemi edhe zonjën Jerina, e cila është këshilltare e Avokatit të Popullit.

Albana Gashi- Bëri pyetje: Kur do të fillojë grupi i punës që të bëjë monitorimin e Ligjit për persona të zhdukur, pasi që kanë kaluar 6 muaj prej hyrjes në fuqi të këtij Ligji?

Mbledhja përfundoi në orën 11:50.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdali